

20180831507

L I G J **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË INVESTIMEVE**

Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen llojet, lartësia, kushtet, mënyra dhe procedura për ndarjen e mbështetjes financiare të investimeve të subjekteve afariste të cilat do të investojnë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 2

Ky ligj paraqet skemë të ndihmës në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet kontrolli i ndihmës shtetërore.

Qëllimi i ligjit

Neni 3

Qëllimi i këtij ligji është nxitja e rritjes dhe zhvillimit ekonomik në Republikën e Maqedonisë përmes mbështetjes së investimeve për rritjen e konkurrencës së ekonomisë së Maqedonisë dhe punësimit.

Kuptimi i nocioneve të përdorura

Neni 4

Nocionet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "Dhënës i ndihmës shtetërore" është Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
2. "Subjekti afarist" është tregtari i regjistruar në Regjistrin e shoqërive tregtare në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë,
3. "Furnizues" është secili subjekt afarist i cili nuk është në mënyrë kapitale apo në çfarëdo mënyre tjetër në pajtim me ligjin i lidhur me shfrytëzuesin e mbështetjes financiare të këtij ligji dhe i cili kryen procese dhe operacioneve paraprake mbi prodhimin i cili dorëzohet dhe inkorporohet në prodhimin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare,
4. "Ndihma shtetërore" është ndihma e dhënë nga dhënësi i ndihmës shtetërore në formë të mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj,
5. "Shpenzime të arsyeshme" janë shpenzimet për investime në mjetet materiale dhe jomateriale dhe/ose shpenzimet për rrogë për vendet e sapokrijuara të punës,
6. "Shpenzime të arsyetuara investuese" janë shpenzimet për investime në mjetet materiale dhe jometariale për nevojat e projektit investues,
7. "Mjete materiale" janë të gjitha mjetet si toka, ndërtesa, pajisje, stabilimente dhe makina të nevojshme për realizimin e projektit investues,
8. "Mjete jomateriale" janë investimet në transfer të teknologjisë, marrja e patentëve, licencave, njohuria dhe përvoja (know-how), të drejtat tjera me pronësi intelektuale të pranuar në legjislacionin nacional në vendin e prejardhjes së të drejtës përkatësisht në Republikën e Maqedonisë apo njohuria teknike e jopatentuar e nevojshme për realizimin e projektit investues,
9. "Shpenzime për rrogë" paraqet shumën e përgjithshme të mjeteve që si bruto rrogë shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet ta paguajë për vendet e punës drejtpërdrejt të krijuara për realizimin e projektit investues,

10. "Lartësia e mbështetjes financiare" është shuma e mbështetjes e shprehur si përqindje nga shpenzimet e arsyeshme investuese apo nga shpenzimet e arsyeshme për pagesë të rrogave për vendet e sapokrijuara të punës,

11. "Shfrytëzues i mbështetjes financiare" është çdo subjekt afarist të cilit i është ndarë mbështetja financiare për realizimin e projektit investues në pajtim me këtë ligj,

12. "Investime fillestare produktive" janë investimet në mjetet materiale dhe/ose jomateriale të lidhura me:

- themelimin e subjektit të ri afarist;
- zgjerimin e kapacitetit të prodhimit të subjektit afarist ekzistues;
- futjen e prodhimeve të reja;
- ndryshimin esencial në tërë procesin e prodhimit të subjektit afarist ekzistues dhe
- fitimin e mjeteve themelore të subjektit afarist që është në procedurë të falimentimit apo likuidimit, me kusht këto të blihen nga subjekti i cili nuk është në lidhshmëri kapitale apo lidhshmëri tjetër në pajtim me ligjin me subjektin nga i cili blihen mjetet;

13. "Makinë e re" është çdo makinë, pajisje apo stabiliment i prodhuar jo më herët se dy vjet nga data e blerjes, që nuk është shfrytëzuar (e paamortizuar) paraprakisht dhe është furnizuar nga shfrytëzuesi i mbështetjes financiare me kushte reale të tregut dhe çmim të përcaktuar në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të pranuar në Republikën e Maqedonisë;

14. "Projekt investues" janë të gjitha aktivitetet që do të merren nga subjekti afarist dhe të cilat përfshijnë investime në ndërtimin e objekteve të reja, përkatësisht përshtatjen, rekonstrukcionin apo ndërtimin plotësues të objekteve ekzistuese, furnizimin e pajisjes, makinave dhe stabilimenteve dhe hapjen e vendeve të reja të punës në pajtim me planin afarist.

15. "Projekt i madh investues" është projekti investues me vlerë mbi 50.000.000 euro në kundërvlerë me denarë.

16. "Fillimi i realizimit të projektit investues" është fillimi i punëve ndërtimore të lidhura me projektin investues në të cilat nuk bëjnë pjesë sigurimi i lejeve, përpilimi i studimeve të fizibilitetit dhe aktivitetet të ngjashme për çka shfrytëzuesi i mbështetjes financiare e njofton kërkuesin; akti i parë obligues juridik për porosi të pajisjes; përkatësisht akti obligues juridik me të cilin merren obligime për shkak të së cilave investimi nuk mund të kthehet në gjendjen e mëhershme.

Kohëzgjatja e projektit investues

Neni 5

Projekti investues për të cilin ndahet mbështetja financiare në pajtim me këtë ligj nuk mund të zgjasë më tepër se pesë vjet nga dita e fillimit të realizimit të projektit investues.

Pjesëmarrja e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në financim

Neni 6

Pjesëmarrja e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në investim duhet të arrijë së paku 25% të shpenzimeve të përgjithshme dhe të arsyeshme investuese përmes mjeteve personale apo nga burimet tjera të financimit që nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.

Obligimi për paraqitjen e projekteve të mëdha

Neni 7

Për secilin projekt të madh investues, dhënësi i ndihmës shtetërore detyrimisht e njofton Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në pajtim me ligjin.

Kumulacioni i mbështetjes financiare

Neni 8

(1) Mbështetja e përgjithshme financiare e cila mund të paguhet në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër nuk mund të tejkalojë 50% nga lartësia e shpenzimeve të arsyeshme të realizuara.

(2) Për projekte të mëdha investuese lartësia e mbështetjes financiare të këtij ligji është:

- deri më 50% nga shpenzimet e arsyeshme investuese për projektin investues deri më 50.000.000 euro;

- deri më 25% për pjesën e shpenzimeve të arsyeshme investuese për projektin investues prej 50.000.000,00 euro deri më 100.000.000 euro dhe

- deri më 17% për pjesën e shpenzimeve të arsyeshme investuese për projektin investues që tejkalojnë 100.000.000 euro.

(3) Kufizimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me mbështetjen financiare që ndahet dhe paguhet për vendosjen e formave organizative për zhvillimin dhe hulumtimin teknologjik.

Subjektet që mund të jenë shfrytëzuese të mbështetjes financiare

Neni 9

(1) Subjektet që mund të jenë shfrytëzuese të mbështetjes financiare janë subjektet afariste:

- të cilat kryejnë veprimtari prodhuese dhe

- të cilat kanë realizuar rritjen e të ardhurave nga veprimtaria në vitin e fundit në lidhje me mesataren e tri viteve paraprake apo për periudhë më të shkurtër nëse subjekti afarist është regjistruar dhe ka filluar me veprimtari në periudhën më të shkurtër se katër vjet të llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për ndarjen e mbështetjes financiare dhe

- të cilat kanë numër mesatar përkatësisht rritje të numrit mesatar të të punësuarve në vitin e fundit në lidhje me mesataren e tri viteve paraprake apo për periudhë më të shkurtër nëse subjekti afarist është regjistruar dhe ka filluar me veprimtari në periudhë më të shkurtër se katër vjet të llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për ndarjen e mbështetjes financiare.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni mbështetje financiare në pajtim me këtë ligj nuk mund t'u ndahet subjekteve afariste të cilat kryejnë veprimtari prodhuese dhe njëherit janë kryerës të:

- veprimtarisë me interes publik të përcaktuara me ligj;

- veprimtarisë së licencuar;

- veprimtarisë së rregulluar;

- shfrytëzuesve të së drejtës së koncesioneve, nëse kjo u është veprimtari dominuese;

- të cilat kryejnë veprimtari të lidhura me prodhimin me dedikim (armatim dhe pajisje ushtarake);

- të cilat prodhojnë mallra të akcizës.

(3) Subjekti afarist i cili do ta fitojë të drejtën të shfrytëzojë mbështetje financiare në pajtim me këtë ligj do ta shfrytëzojë të drejtën nëse vazhdimisht dhe në mënyrë kumulative i përmbush kushtet e parapara në paragrafin (1) të këtij neni.

Subjektet që nuk mund të jenë shfrytëzues të mbështetjes financiare

Neni 10

Mbështetja financiare në pajtim me këtë ligj nuk mund t'u ndahet subjekteve:

- të cilat shfrytëzojnë subvencione, e të cilat kryejnë veprimtari nga sfera e bujqësisë dhe peshkatarisë;

- të cilat kryejnë veprimtari ndërtimore të lidhura me ndërtimin dhe shitjen e banesave dhe ndërtesave banesore edhe atë vetëm për pjesën e veprimtarisë ndërtimore ndërtimi dhe shitja e banesave;

- të cilat kryejnë veprimtari nga sfera e shërbimeve komunikuese informative përveç nëse veprimtaria lidhet me vendosjen e formave organizative për zhvillimin dhe hulumtimin teknologjik.

Kufizimi i mbështetjes financiare

Neni 11

Mbledhja financiare për realizimin e projektit investues në pajtim me këtë ligj nuk mund t'i ndahet subjektit afarist në zonat zhvillimore industriale teknologjike për shpenzimet e njëjta të arsyeshme si dhe subjekteve tjera afariste jashtë zonave zhvillimore industriale teknologjike për shpenzimet e njëjta të arsyeshme për të cilat është ndarë ndihma shtetërore.

Realizimi i mbështetjes financiare

Neni 12

(1) Mbështetja financiare ndahet për investime dhe përmirësimin e konkurrencës, kurse paguhet në vitin rrjedhës në pajtim me nenin 9, paragrafi (1) alineja 2 e këtij ligji.

(2) Mbështetja financiare e cila u ndahet subjekteve afariste në pajtim me këtë ligj do të realizohet në nivel vjetor me pagesë të drejtpërdrejtë në llogarinë e shfrytëzuesit në procedurën e përcaktuar me këtë ligj dhe në pajtim me marrëveshjen e lidhur për mbështetje financiare.

Kthimi i zbatimit të mbështetjes financiare në rast të mospërmbushjes së obligimeve të marra

Neni 13

Në rast të mospërmbushjes së obligimeve të marra në bazë të marrëveshjes së lidhur për ndarjen e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj, shfrytëzuesi i mbështetjes financiare ka për detyrë ta kthejë zbatimin e mbështetjes financiare në vëllimin, afatin dhe në mënyrën e rregulluar me marrëveshjen për mbështetjen financiare.

Llojet e mbështetjes financiare

Neni 14

(1) Llojet e mbështetjes financiare për investime janë:

- a) Mbështetja për punësime të reja;
 - b) Mbështetja për vendosjen dhe përparimin e bashkëpunimit me furnizuesit nga Republika e Maqedonisë;
 - v) Mbështetja për vendosjen e formave organizative për zhvillimin dhe hulumtimin teknologjik;
 - g) Mbështetja për projektet investuese me interes të rëndësishëm ekonomik;
 - d) Mbështetja për rritjen e investimeve kapitale dhe të ardhurave dhe
 - gj) Mbështetja për blerjen e mjeteve nga ndërmarrjet në vështirësi.
- (2) Llojet e mbështetjes financiare për konkurrencë janë:
- a) Mbështetja për rritjen e konkurrencës së tregut;
 - b) Mbështetja për përvetësimin e tregjeve dhe rritjen e shitjes.

Mbështetja financiare për punësime të reja

Neni 15

(1) Mbështetja financiare për punësime të reja ndahet për punësime të reja të shtetasve të Republikës së Maqedonisë me orar të plotë të punës.

(2) Subjekti afarist i cili do të paguajë vazhdimisht rrogë neto mujore e cila është më pak për 50% më e lartë nga rroga neto minimale të paraparë me Ligjin për rrogë minimale në Republikën e Maqedonisë ka të drejtën e mbështetjes financiare në shumë prej 20% të rrogës së paguar neto mujore për çdo punësim të ri gjatë vitit paraprak.

(3) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (2) i këtij neni e cila mund të ndahet për një punësim të ri është 4.400 euro. Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare përcaktohet në mënyrë proporcionale për periudhën nga dita e punësimit.

(4) Mbështetja financiare nga paragrafi (2) i këtij neni nuk mund të ndahet për periudhën kohore më të gjatë se pesë vjet duke llogaritur nga dita e punësimit të parë në vendin konkret të punës.

Neni 16

Për ndarjen e mbështetjes financiare nga neni 15 të këtij ligji subjekti afarist duhet t'i përmbush kushtet në vijim:

1. Të realizojë rritjen e të ardhurave nga veprimtaria dhe të numrit mesatar të të punësuarve në pajtim me nenin 9 të këtij ligji dhe

2. Së paku 75% të personave të sapopunësuar gjatë vitit për të cilën kërkohet mbështetja financiare duhet të jenë persona të cilët e përmbushin së paku njërin ndër kushtet në vijim:

- së paku 3 muaj para punësimit të mos kenë marrëdhënie të themeluar pune dhe së paku 12 muaj para punësimit të mos jenë të punësuar te shfrytëzuesi i mbështetjes financiare apo në subjektin e lidhur afarist; apo

- për herë të parë themelojnë marrëdhënie pune me të apo

- marrëdhënia e fundit e punës t'u pushojë për shkak të hapjes së procedurës së falimentimit apo procedurës së likuidimit apo

- menjëherë para punësimit të jetë i punësuar në administratën publike apo shtetërore.

Mbështetja financiare për vendosjen dhe përparimin e bashkëpunimit me furnizuesit e regjistruar në Republikën e Maqedonisë

Neni 17

(1) Mbështetja financiare për vendosjen dhe përparimin e bashkëpunimit afarist me furnizuesit e regjistruar në Republikën e Maqedonisë ka të bëjë me subjektet afariste të cilat kryejnë veprimtari në zonat zhvillimore industriale teknologjike, të cilat do të furnizojnë dhe inkorporojnë prodhime në produktin përfundimtar nga furnizuesit e regjistruar në Republikën e Maqedonisë që kryejnë veprimtari prodhuese.

(2) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni arrin 1% të vlerës së furnizimeve të përgjithshme të kryera me kusht 15% të prodhimit të fundit i cili dorëzohet dhe inkorporohet në prodhimin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare në vitin paraprak, të kryhet nga furnizuesit e regjistruar në Republikën e Maqedonisë.

(3) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (2) të këtij neni nuk mund të arrijë më tepër se 300.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(4) Bashkëpunimi afarist nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet në pajtim me pjesëmarrjen procentuale të furnizimeve të prodhimeve që dorëzohen dhe inkorporohen në prodhimin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare nga furnizuesit. Me këtë rast nuk merren parasysh

furnizimet e kryera nga ndërmarrjet publike (energjia elektrike, karburantet, gazi, uji, komunaliet, shërbimet e telekomit, etj.) si dhe shërbimet e avokatit, të kontabilistit apo shërbimet konsultuese.

(5) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) të këtij neni nuk mund të ndahet për periudhën kohore më të gjatë se shtatë vjet nga data e fillimit të shfrytëzimit të mbështetjes.

Neni 18

Për realizimin e të drejtës së mbështetjes financiare nga neni 17 i këtij ligji duhet të përmbushen kushtet vijuese edhe atë:

- shfrytëzuesi të realizojë rritje të të hyrave nga veprimtaria dhe me numrin mesatar të të punësuarve në pajtim me nenin 9 të këtij ligji dhe

- shfrytëzuesi të ketë realizuar furnizim nga furnizuesi i regjistruar në Republikën e Maqedonisë i cili nuk është në mënyrë kapitale ose në cilëndo mënyrë në pajtim me ligjin e lidhur me shfrytëzuesin e mbështetjes financiare dhe që kryen procese dhe operacione paraprake mbi prodhimin që dorëzohet dhe inkorporohet në prodhimin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare.

Neni 19

Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare nga neni 17 i këtij ligji ka për obligim ta mbajë veprimtarinë së paku tre vjet duke llogaritur nga viti i fundit për të cilin është paguar mbështetja financiare.

Mbështetja financiare për vendosjen e formave organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim

Neni 20

(1) Mbështetja financiare për vendosjen e formave organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim ndahet për themelim të seksioneve, qendrave ose formës tjetër të strukturës organizative në të cilat realizohen projekte të qëndrueshme hulumtuese dhe zhvillimore dhe angazhohet personel me kualifikim të lartë me qëllim përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja për zhvillim të prodhimeve të reja, proceseve dhe shërbimeve prodhuese, ose për përmirësimin e konsiderueshëm të prodhimeve ekzistuese, proceseve dhe shërbimeve prodhuese në veprimtaritë prodhuese.

(2) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni u ndahet subjekteve afariste që do të formojnë forma organizative të mëvetësishme për zhvillim teknologjik dhe hulumtim, ose do të formohen si pjesë e strukturës organizative ekzistuese.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni është deri në 50% e shpenzimeve të përgjithshme të arsyetuara për hulumtim industrial për shfrytëzues nga të cilat 30% ndahen për shpenzime investuese nga paragrafi (4), alineja 1 e këtij neni, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës për projekt për të cilin janë gjeneruar shpenzime investuese.

(4) Shpenzime të arsyetuara investuese nga paragrafi (1) i këtij neni janë:

- shpenzimet për instrumente dhe pajisje që shfrytëzohen për nevojat e projektit hulumtues;
- shpenzimet për ndërtesa dhe tokë në të cilën do të vendoset formë organizative për zhvillim teknologjik;
- shpenzimet për hulumtim të kontraktuar, njohuri teknike dhe patenta të blera ose të licencuara nga ana e burimeve të jashtme me çmime të tregut;
- shpenzimet plotësuese të krijuara drejtpërdrejt si rezultat i projekteve hulumtuese;
- shpenzimet tjera operative, përfshirë edhe shpenzimeve për materiale, furnizime dhe prodhime të ndryshme të krijuara drejtpërdrejt si rezultat i veprimtarisë hulumtuese.

(5) Mbështetja financiare nga paragrafi (3) i këtij neni ndahet për periudhë kohore jo më gjatë se pesë vjet llogaritur nga viti në të cilin është parashtruar kërkesa për ndarje të mbështetjes financiare.

Neni 21

(1) Për realizimin e të drejtës së mbështetjes financiare nga neni 20 i këtij ligji subjekti afarist duhet të përmbushë kushtet vijuese edhe atë:

- të realizojë rritje të të hyrave nga veprimtaria dhe me numrin mesatar të të punësuarve në lidhje me të hyrat e realizuara dhe numrin mesatar të të punësuarve në pajtim me nenin 9 të këtij ligji;

- veprimtaria kryesore e subjektit afarist të jetë nga sfera e prodhimit; dhe

- aktivitetet dhe rezultatet e formës organizative për zhvillim teknologjik dhe hulumtim të jenë të aplikueshme në prodhim.

(2) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet ta mbajë numrin mesatar të të sapopunësuarve nëse ka shfrytëzuar mbështetje financiare për pagesë të neto rrogave nga neni 15 i këtij ligji, për periudhë prej së paku tre vjet nga viti i fundit për të cilin është paguar mbështetja financiare.

Mbështetja financiare për projektet investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë

Neni 22

Projekte investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë janë:

- projekte investuese investimi i të cilëve është së paku 4.000.000 euro dhe siguron së paku 300 vende të reja pune ose

- projekte investuese investimi i të cilëve është se paku 20.000.000 euro.

Neni 23

(1) Mbështetja financiare për projektet investuese me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë përbëhet prej:

a) pagesës së mjeteve në lartësi të tatimit të paguar personal të të ardhurave nga rrogat e të punësuarve shtetas të Republikës së Maqedonisë;

b) pagesa e mjeteve në lartësi të tatimit të paguar mbi fitim;

v) mjete monetare në shumë deri në 10% nga shuma e realizuar e investimeve (mjete materiale dhe jomateriale) të parapara me marrëveshje të realizuara për lidhje të Marrëveshjes për ndarje të mbështetjes financiare por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës;

g) pagesa e mjeteve në para për çdo të punësuar për të cilin është paguar neto rroga më e lartë për së paku 50% më të lartë nga lartësia e neto rrogës minimale të përcaktuar me Ligjin për rrogë minimale në Republikën e Maqedonisë edhe atë:

- shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës për subjekt afarist i cili punëson deri në 300 persona;

- shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës për subjekt afarist vetëm për pjesën e të punësuarve nga 301 deri në 500;

- shumë prej 3.500 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës për subjekt afarist vetëm për pjesën e të punësuarve nga 501 deri në 1000;

- shumë prej 4.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës për subjekt afarist vetëm për pjesën e të punësuarve nga 1001 deri në 2000 persona.

(2) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) pika a) dhe b) e këtij neni nuk mund t'u ndahet shfrytëzuesve që shfrytëzojnë mbështetje financiare të llojit të njëjtë në pajtim me ligjin.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) pika v) e këtij neni nuk mund t'u ndahet shfrytëzuesve që shfrytëzojnë mbështetje financiare të nenit 25 të këtij ligji.

(4) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) pika g), alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni nuk u ndahet shfrytëzuesve që shfrytëzojnë mbështetje financiare nga neni 15 i këtij ligji.

Neni 24

(1) Mbështetja financiare nga neni 23 paragrafi (1) pika a) e këtij ligji realizohet në nivel vjetor në kohëzgjatje prej 10 vitesh duke llogaritur nga muaji për të cilin për herë të parë u është paguar rrogë të punësuarve, por jo më vonë se një vit duke llogaritur nga data e lidhjes së marrëveshjes për mbështetje financiare.

(2) Mbështetja financiare nga neni 23 paragrafi (1) pika b) e këtij ligji realizohet në nivel vjetor në kohëzgjatje prej 10 vitesh duke llogaritur nga data kur subjekti afarist ka filluar me veprimtari, përkatësisht jo më vonë se një vit duke llogaritur nga viti i lidhjes së marrëveshjes për mbështetje financiare.

(3) Mbështetja financiare nga neni 23 paragrafi (1) pika v) e këtij ligji realizohet në nivel vjetor për periudhë prej tre vitesh llogaritur nga viti i lidhjes së marrëveshjes për mbështetje financiare, përkatësisht jo më vonë se viti i fillimit të projektit investues.

(4) Mbështetja financiare nga neni 23 paragrafi (1) pika g) alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji do të paguhet përnjëherë për çdo vend të ri të krijuar në nivel vjetor për periudhë prej katër vitesh duke llogaritur nga viti i lidhjes së marrëveshjes, përkatësisht nga viti i fillimit të projektit investues.

(5) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet ta mbajë investimin dhe vendet e sapokrijuara të punës për periudhë prej së paku pesë vitesh nga viti i fundit në të cilin ka përfunduar projekti investues.

Mbështetja financiare për rritje të investimeve dhe të hyrave kapitale

Neni 25

(1) Mbështetja financiare për rritje të investimeve dhe të hyrave kapitale është mbështetje për subjekte afariste që realizojnë investime fillestare ose plotësuese për furnizim të makinave dhe pajisjeve të reja ose për investime në objekte dhe tokë të nevojshme për veprimtarinë e shfrytëzuesit në kuadër të projektit investues.

(2) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të jetë 10% nga investimi i realizuar, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës në mënyrë të përgjithshme për kohëzgjatjen e gjithë projektit investues.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të paguhet në nivel vjetor për periudhë kohore prej pesë vitesh nga data e fillimit të projektit investues.

Neni 26

(1) Për realizimin e mbështetjes financiare nga neni 25 i këtij ligji subjekti afarist duhet të mos e zvogëlojë numrin mesatar të të punësuarve dhe të hyrat nga veprimtaria e punës nën mesataren në tre vitet paraprake ose për periudhë më të shkurtër varësisht nga data në të cilën subjekti afarist është themeluar ose ka filluar me veprimtarinë.

(2) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet ta mbajë investimin dhe vendet e sapokrijuara të punës për periudhë prej së paku pesë vitesh nga viti i fundit në të cilin ka përfunduar projekti investues.

Mbështetja financiare për blerje të mjeteve materiale nga subjekte afariste me vështirësi

Neni 27

(1) Mbështetja financiare për blerje të mjeteve materiale nga subjekte afariste me vështirësi u ndahet subjekteve afariste që do të fillojnë projekt investues dhe kanë blerë mjete materiale të subjektit afarist në procedurë të falimentimit ose likuidimit që do t'i shfrytëzojnë veçanërisht në procesin e prodhimit në kuadër të projektit investues.

(2) Shuma maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të jetë 10% nga shpenzimet për blerje të mjeteve materiale të subjektit afarist në falimentim ose likuidim, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni paguhet në mënyrë të njëhershme në afat prej 12 muajsh duke llogaritur nga dita e fillimit të procesit të prodhimit.

(4) Shfrytëzimi i mbështetjes financiare nga paragrafi (1) i këtij neni e përjashton shfrytëzimin e mbështetjes financiare nga neni 25 i këtij ligji.

Neni 28

(1) Për realizimin e mbështetjes financiare nga neni 27 i këtij ligji duhet të përmbushen kushtet vijuese edhe atë:

- të jetë subjekt afarist i cili në periudhën nga tre vitet e fundit para hapjes së procedurës së falimentimit ose likuidimit përveç përmes bashkëpunimit afarist nuk është lidhur në cilëndo mënyrë me subjektin afarist që nuk është në procedurë të falimentimit ose likuidimit dhe

- të blejë mjete materiale nga subjekti afarist i cili është në procedurë të falimentimit ose likuidimit dhe i cili para hapjes së procedurës së falimentimit ose likuidimit ka pasur së paku 50 të punësuar.

(2) Shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet ta ruajë projektin investues për të cilin janë blerë mjete materiale së paku pesë vjet pas datës së fillimit të projektit investues.

Mbështetje financiare për rritje të konkurrencës së tregut

Neni 29

(1) Mbështetja financiare për subjekte afariste që e kanë rritur konkurrencën e vet në tregun ndahet për realizimin e rritjes së sasive të shitura ose rritjes së të hyrave nga veprimtaria për prodhime të shitura në treg.

(2) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të jetë 10% nga shpenzimet e arsyetuara investuese por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës në nivel vjetor.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të ndahet në nivel vjetor, por jo më shumë se pesë vjet duke llogaritur nga data e fillimit të projektit investues.

Neni 30

Për realizimin e të drejtës së mbështetjes financiare nga neni 29 i këtij ligji shfrytëzuesi i mbështetjes financiare duhet t'i përmbushë kushtet vijuese edhe atë:

- të realizojë rritje të sasive të shitura ose rritje të të hyrave nga veprimtaria për prodhime të shitura në treg në vitin për të cilin aplikon, për së paku 5% më shumë se mesatarja në tre vitet e fundit dhe

- të mbajë ose të realizojë rritje të numrit mesatar të të punësuarve dhe rritje të të hyrave nga veprimtaria e të punësuarve prej së paku 5% mbi mesataren në tre vitet paraprake, ose për periudhë më të shkurtër varësisht nga data në të cilën ndërmarrja është themeluar ose ka filluar me veprimtarinë të përcaktuar në pajtim me marrëveshjen për mbështetje financiare.

Mbështetja financiare për pushtimin e tregjeve të reja dhe rritje të shitjes

Neni 31

(1) Mbështetje financiare për pushtimin e tregjeve të reja dhe rritje të shitjes u ndahet subjekteve afariste për shpenzime të arsyetuara për pushtimin e tregjeve të reja dhe realizim të rritjes në shitjen e tregjeve të reja që kanë të bëjnë me:

- paraqitje të përbashkët (të organizuar) në panaire jashtë vendit;
- paraqitje të përbashkët (të organizuar) në evenimente afariste gjatë vizitave të shteteve;
- takime afariste me firma në tregjet e huaja;
- hulumtim të tregjeve të huaja;
- certifikimi i prodhimeve në pajtim me kërkesat e tregjeve të huaja;
- përgatitje për paraqitje marketingu në tregjet e huaja (përpunimi i materialit promovues, katalogjeve, broshurave, dizajnit të uebfaqeve).

(2) Shuma vjetore maksimale e mbështetjes financiare nga paragrafi (1) i këtij neni do të jetë 20% nga shpenzimet e arsyetuara investuese por jo më shumë se 30.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(3) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me shfrytëzuesit e zonave zhvillimore teknologjike-industriale.

(4) Mbështetja financiare nga paragrafi (1) i këtij neni paguhet në nivel vjetor, ndërsa do të ndahet vazhdimisht deri në arritjen e shumës maksimale nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 32

Për realizimin mbështetjes financiare nga neni 31 i këtij ligji shfrytëzuesi duhet ta mbajë numrin e njëjtë ose të realizojë rritje të numrit mesatar të të punësuarve dhe të realizojë rritje të të hyrave nga veprimtaria e punës në pajtim me nenin 9 të këtij ligji.

Neni 33

Për kontribute investime fillestare të subjekteve afariste të themeluara nga shtetas të Republikës së Maqedonisë, të cilët kanë vendbanim ose qëndrim të përkohshëm jashtë Republikës së Maqedonisë, shuma e mbështetjes financiare nga neni 23 paragrafi (1) nën v), neni 25 paragrafi (2), neni 27 paragrafi (2) dhe neni 29 paragrafi (2) i këtij ligji, rritet për 10% nga investimi i realizuar, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

Procedura për ndarje të mbështetjes financiare

Neni 34

(1) Mbështetjen financiare në pajtim me këtë ligj e ndan Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Marrëveshjet për mbështetje financiare në emër të Qeverisë i nënshkruan një prej nënshkruesve vijues:

- Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i ngarkuar për çështje ekonomike dhe për koordinim me resorët ekonomikë;
- Ministri i Ekonomisë;
- Ministrat pa resor të ngarkuar për investime të huaja;
- Ministri pa resor, i ngarkuar për rregullativë për përmirësimin e klimës investuese për ndërmarrjet vendore;
- Drejtori i Drejtorisë për Zona Zhvillimore Industriale Teknologjike;
- Drejtori i Agjencisë për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit të Republikës së Maqedonisë.

Mjetet për mbështetje financiare

Neni 35

Mbështetja financiare nga nenet 15, 17, 20, 23, 25, 27, 29, 31 dhe 33 të këtij ligji aprovet deri në shumën e mjeteve për atë qëllim të përcaktuara në buxhetin për vitin rrjedhës të institucioneve kompetente për pagesë.

Organet kompetente për zbatimin e procedurës për ndarje të mbështetjes financiare

Neni 36

(1) Organet kompetente për zbatimin e procedurës për ndarje të mbështetjes financiare janë Drejtoria për zona teknologjike industriale zhvillimore dhe Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit.

(2) Për projekte investuese në zonat teknologjike industriale zhvillimore subjektet afariste parashtrajnë kërkesa për shfrytëzim të mbështetjes financiare në Drejtorinë për zona teknologjike industriale zhvillimore.

(3) Për projekte investues jashtë zonave zhvillimore industriale teknologjike subjektet afariste parashtrajnë kërkesë për shfrytëzimin e mbështetjes financiare në Agjencinë e investimeve të huaja dhe promovim të eksportit të Republikës së Maqedonisë.

Procedura për ndarje të mbështetjes financiare

Neni 37

(1) Për ndarjen e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj, subjekti afarist parashtron kërkesë për ndarje të mbështetjes financiare deri te organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) i këtij ligji.

(2) Me kërkesën dorëzohet Letër e qëllimeve, plan afarist për projekt investues dhe raport financiar për tre vitet e fundit ose për periudhë më të shkurtër varësisht nga data në të cilën subjekti afarist është themeluar ose ka filluar me veprimtari.

(3) Përveç dokumenteve nga paragrafi (1) i këtij neni organi kompetent nga neni 36, paragrafët (2) dhe (3) i këtij ligji mund të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës të dorëzojë edhe dokumente tjera me të cilat vërtetohen të dhëna dhe fakte të cekura në Kërkesën për mbështetje financiare.

(4) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni si dhe dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafi (3) i këtij neni i përcakton ministri i Ekonomisë.

Neni 38

(1) Organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) i këtij ligji më së voni deri në fund të muajit rrjedhës i shqyrtojnë kërkesat e arritura në muajin paraprak dhe dokumentacionin e dorëzuar me ç'rast e përcaktojnë plotësinë e kërkesës dhe dokumentacionit të dorëzuar si dhe nëse kërkesat e parashtruara i përmbushin kushtet për ndarjen e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj në bazë të të cilës përpilon raport me shkrim për kërkesat e shqyrtuara.

(2) Nëse kërkesat e dorëzuara dhe dokumentacioni nga paragrafi (1) i këtij neni nuk janë të kompletuara organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dorëzojnë njoftim në afat prej tetë ditësh nga shqyrtimi i kërkesës, deri te kërkuesi me sugjerim për plotësimin e kërkesës së parashtruar me dokumentacionin e nevojshëm në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të njoftimit.

(3) Nëse kërkuesi nuk vepron në pajtim me paragrafin (2) i këtij neni organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji do ta njoftojnë kërkuenin në afat prej tetë ditësh nga skadimi i afatit për plotësim të kërkesës, se kërkesa për shkak të moskompletimit nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit në procedurën për ndarje të mbështetjes financiare.

(4) Nëse kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i përmbush kushtet për ndarjen e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj, kërkuetit në afat prej tetë ditësh nga shqyrtimi i kërkesës së kompletuar të dorëzuar i dorëzohet njoftim se nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit në procedurë për ndarje të mbështetjes financiare.

(5) Organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji në Komisionin për evaluim të kërkesave për mbështetje financiare për investime të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni për Evaluim) në afat prej 15 ditësh e dorëzon raportin me shkrim nga paragrafi (1) i këtij neni me të gjitha kërkesat me dokumentacion të nevojshëm të cilat i përmbushin kushtet në pajtim me këtë ligj për ndarje të mbështetjes financiare.

(6) Komisionin për Evaluim nga paragrafi (5) i këtij neni e përbëjnë nga një anëtar nga Zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i ngarkuar për çështje ekonomike dhe për koordinim me resorët ekonomikë, kabinetet e ministrave pa resorë të ngarkuar për investime të huaja, Kabineti i ministrit pa resor i ngarkuar për rregullativë për përmirësimin e klimës investuese për ndërmarrjet vendore, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Financave, Drejtoria për zona teknologjike industriale zhvillimore, Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit të Republikës së Maqedonisë. Anëtarëve të Komisionit për Evaluim u takon kompensim, të cilin e cakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në bazë të numrit të kërkesave të shqyrtuara dhe numrit të mbledhjeve të mbajtura. Me punën e Komisionit kryeson anëtari nga Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i ngarkuar për çështje ekonomike dhe për koordinim me resorët ekonomikë.

(7) Për mënyrën e punës së vet Komisioni për Evaluim miraton Rregullore për punë.

(8) Komisioni për punën e vet së paku dy herë në vjet dorëzon Raport për punën e vet deri në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

(9) Komisioni për Evaluim e shqyrton raportin me shkrim me kërkesat dhe dokumentacionin e marrë nga paragrafi (5) i këtij neni dhe në afat prej 15 ditësh nga pranimi i tyre përpilon Raport. Raporti përmban: numrin e kërkesave të marra, llojin e mbështetjes financiare dhe lartësinë e mjeteve financiare të nevojshme për ndarje të tyre, listën e subjekteve afariste dhe projektet investuese kërkesat e të cilave i përmbushin kushtet për lidhje të marrëveshjes për mbështetje financiare, si dhe mendim për plotësinë e kushteve për marrje të mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj. Raporti duhet të nënshkruhet prej së paku dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

(10) Raporti nga paragrafi (9) i këtij neni, dorëzohet në organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) i këtij ligji në afat prej 15 ditësh nga përpilimi i Raportit nga paragrafi (9) i këtij neni.

Neni 39

Organet kompetente të nenit 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji në bazë të Raportit të Komisionit për Evaluim nga neni 38 paragrafi (9) të këtij ligji, më së voni në afat prej 30 ditësh nga marrja e Raportit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dorëzojnë draft marrëveshje për marrjen e pëlqimit për ndarjen e mbështetjes financiare.

Marrëveshje për përkrahje financiare

Neni 40

(1) Marrëveshja për ndarjen e mbështetjes financiare në veçanti i përmban elementet në vijim:

- palët kontraktuese;
- lëndën e Marrëveshjes për ndarjen e mbështetjes financiare;
- lojin e mbështetjes financiare që ndahet me Marrëveshje për ndarjen e mbështetjes financiare;
- të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese;
- afatet për plotësimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërmarra;
- mënyrën e pagesës së përkrahjes financiare;
- dispozitat në rast të mos plotësimit të obligimeve të ndërmarra;
- dispozita për ndërpreje;
- dispozita për prishje të marrëveshjes;
- dispozita për zgjidhjen e kontesteve.

(2) Marrëveshja për përkrahje financiare e cila nuk i përmban elementet nga paragrafi (2) i këtij neni është e pavlefshme.

Njoftimi dhe evidenca për marrëveshjen e lidhur për ndarjen e mbështetjes financiare

Neni 41

(1) Drejtoria për Zona Zhvillimore Industriale Teknologjike mban evidencë për të gjitha marrëveshjet e lidhura për ndarjen e ndihmës financiare dhe në emër të dhënësit të ndihmës financiare dorëzon raport vjetor në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, një herë në vit.

(2) Kopje e kontratës për ndarjen e ndihmës financiare menjëherë, por më së voni në afat prej tre ditësh pas nënshkrimit i dërgohet organit që mban evidencën marrëveshjeve të lidhura për mbështetje financiare.

Përcjellja e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura për ndarjen e mbështetjes financiare

Neni 42

Organet kompetente nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij Ligji e përcjellin zbatimin e marrëveshjeve të lidhura për ndarjen e ndihmës financiare.

Pagesa e mbështetjes financiare

Neni 43

(1) Shfrytëzuesi i ndihmës financiare që i ka plotësuar kushtet sipas marrëveshjes për mbështetje financiare më së voni deri më 30 qershor të vitit rrjedhës për pagesën e mjeteve në pajtim me marrëveshjen e lidhur për mbështetje financiare paraqet kërkesë për pagesën e

mbështetjes financiare me dokumentacionin e nevojshëm në organin kompetent nga neni 36, paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji. Nëse organi kompetent nuk është nënshkruar i marrëveshjes për mbështetje financiare kërkesa për pagesë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë duhet të dorëzohet nëpërmjet organit kompetent nga neni 36 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji.

(2) Organet kompetente për pagesë nga paragrafi (1) i këtij neni e shqyrtojnë Kërkesën për pagesën e ndihmës financiare dhe pas përcaktimit se janë plotësuar kushtet për shfrytëzimin e ndihmës financiare të paraparë me këtë ligj do të kryejë pagesën në shumën që i takon shfrytëzuesit jo më vonë se 60 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës së kompletuar për pagesë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri i Ekonomisë.

Mbikëqyrja

Neni 44

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen Ministria e Ekonomisë.

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 45

Subjektet afariste që do të lidhin marrëveshje për mbështetje financiare nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fund të korrikut 2018, mund të parashtrojnë kërkesa për pagesën e mbështetjes financiare për shpenzimet investuese të arsyeshme të realizuara në patim me këtë ligj më së voni deri më 30.11.2018. Mbështetja e miratuar financiare do të paguhet më së voni deri më 31.12.2018.

Neni 45-a

(1) Subjektet afariste të industries së përpunimit të lëkurave dhe të tekstilit, më së voni në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të parashtrojnë kërkesa për pagesën e mbështetjes financiare për realizimin e shpenzime të arsyeshme investuese me ç'rast për këto subjekte afariste nuk zbatohen kufizimet nga neni 9 paragrafi (1) alineja 3 të këtij ligji.

(2) Subjektet afariste nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrojnë kërkesa për pagesën e mbështetjes financiare për realizimin e shpenzimeve të arsyeshme investuese, vetëm në rastin kur kanë realizuar rritje të të hyrave nga veprimtaria në vitin e fundit në raport me mesataren nga tri vitet paraprake ose për periudhë më të shkurtër nëse subjekti afarist është regjistruar dhe ka filluar me veprimtari në periudhë më të shkurtër se katër vite, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për ndarjen e mbështetjes financiare.

Miratimi i akteve nënligjore

Neni 46

Aktet nënligjore, të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zbatimi i dispozitave të caktuara

Neni 47

(1) Subjektet afariste që janë shfrytëzues të zonave zhvillimore teknologjike industriale dhe të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji kanë lidhur marrëveshje për ndihmë shtetërore në pajtim me Ligjin për zonat zhvillimore teknologjike industriale dhe të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj mund të parashtrojnë kërkesë për ndarjen e mbështetjes financiare.

(2) Subjektet afariste të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji që kanë lidhur marrëveshje për ndihmë shtetërore në pajtim me Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore dhe të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj mund të parashtrojnë kërkesë për ndarjen e mbështetjes financiare.

Hyrja në fuqi

Neni 48

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.